



Instituti per Studime Publike & Ligjore



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
BASHKIA LIBRAZHD

Librazhd, 27.03.2017

## NJOFTIM PER SHTYP

Bashkia Librazhd dhe Instituti për Studime Publike e Ligjore organizuan takimin “Modeli Win-Win për Strategjinë dhe Projektet e Zhvillimit të Bashkisë Librazhd” në kuadër të një projekti për Pjesëmarrjen Qytetare në Qeverisjen Vendore, zbatuar nga Instituti i Studimeve Publike e Ligjore dhe financuar nga Ambasada e Zvicrës përmes programit Lëviz Albania.

Takimi, i zhvilluar në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Librazhd, solli së bashku autoritete të bashkisë, përfshirë këshilltarë të Bashkisë dhe administratorë të njësive vendore, si dhe përfaqësues nga: bizneset ose organizimet e tyre; organizata jo-fitimprurëse; grupe të ndryshme interesi; individë të shquar në sektorë të caktuar. Bashkia Librazhd është një nga dy bashkitë pilote të përzgjedhura nga projekti për testimin e një shembulli të praktikës së mirë, që mund të replikohet më pas në bashki të tjera.

Gjatë harkut kohor tetor 2016- mars 2017, projekti mundësoi *përfshirjen e drejtpërdrejtë qytetare* në përgatitjen, diskutimin dhe vendimmarrjen për programet afatmesme të zhvillimit vendor dhe mbi 160 projekt- propozime vendore, me interes të gjerë komunitar, sipas një modeli të bazuar në një instrument të unifikuar, të adoptuar nga Këshilli i Europës. Ai gjithashtu ka ndihmuar në procesin e përgatitjes së Strategjisë së Zhvillimit 15 vjecare të Bashkisë Librazhd dhe në përgatitjen e një Rregulloreje të Bashkisë për të mundësuar programimin vendor me pjesëmarrje qytetare në vazhdimësi.

Në këtë takim përmbyllës të projektit në Bashkinë Librazhd, pas prezantimeve dhe diskutimeve të hapura u arrit:

1. Të sigurohet mbështetja e pjesëmarrësve për përzgjedhjen përfundimtare të 25 projekteve më parësore që janë pjesë e buxhetit të bashkisë 2017.
2. Të diskutohet më thellësisht dhe sigurohet mbështetja e pjesëmarrësve për katër projekte nga lista e mësipërme për shqyrtim të mëtejshëm dhe vendim zyrtar nga Këshilli i Bashkisë Librazhd në mbledhjen e saj më të afërt.
3. Të diskutohet dhe sigurohet mbështetja e pjesëmarrësve për projekt-Rregulloren e Bashkisë Librazhd “Për Përgatitjen e Projekteve me Pjesëmarrje Qytetare”.

Projekti pritet të konkludojë me miratimin zyrtar nga Këshilli i Bashkisë Librazhd në mbledhjen më të afërt të tij, të deri katër projekteve me pjesëmarrje të gjerë qytetare, si dhe të Rregullores së Bashkisë “Për Përgatitjen e Projekteve me Pjesëmarrje Qytetare”, e cila do të mundësojë në vazhdimësi përgatitjen e projekteve të ardhshme sipas të njëjtit model gjithë përfshirës.

Së fundi, mbi bazën e arritjeve në kuadër të këtij projekti, Bashkia pritet të konkludojë e miratojë në të ardhmen Strategjinë e Zhvillimit 15 vjecare të Bashkisë Librazhd dhe të përmirësojë ndjeshëm faqen e saj zyrtare të internetit si një instrument i rëndësishëm ndihmës i zbatimit të kësaj strategjie.